



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KËSHILLI I BASHKISË SHIJAK

VENDIM

NR 15 DATË 21.06.2017

**MIRATIMIN E LISTËS SHUMË EMËRORE TË FAMILJEVE TË CILËT DO TË PËRFITOJNË STATUSIN SI TË PASTREHË**

Keshilli i Bashkisë Shijak në mbledhjen e tij të zhvilluar në datë 21.06.2017 bazuar në Ligjin Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 8 pika 2 Neni 9 pika 1.1a dhe 1.1/5, Neni 30 pika 7, Neni 54/dh, Ligjin Nr 9232, datë 13.05.2004 “ Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” Të ndryshuar Neni 13, 14 , 15, 16, Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës , Vendimin Nr 574 datë 29.08.2012 “ Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njerit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të proceduarve të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Udhëzim Nr 23 datë 30.12.2008 “Për përmbajtjen e bonusit të strehimit”, Vendim Nr 814 datë 03.12.2004 “ Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit Nr 1093 datë 28.12.2015 “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit, të VKB Nr 38 datë 30.11.2016 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për grupet e familjeve të pafavorizuara për strehim”, Njoftimin Nr. 108 prot datë 13.01.2017 “Për kërkesat dhe dokumentacionin për të përfituar nga një prej programeve të strehimit social”:

VENDOSI :

- 1- Miratimin e listës shumë emërore të familjeve të cilët kanë aplikuar për të përfituar statusin si të pastrehë në Bashkinë Shijak, sipas tabelës Nr.1 bashkëlidhur bashkëlidhur.
- 2- Ngarkohet juristi i Bashkisë të ndjekë zbatimin e këtij vendimi;
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr 139/2015 neni 55, pika 6.

P/KËSHILLIN E BASHKISË

KRYETARI

TAULAND XHERAJ

